


Ligjërata I

HYRJE NË MAKROEKONOMI

⇒ Në këtë ligjëratë do të njiheni me:

- *Ekonomiksi: makroekonomia, mikroekonomia*
- *Mendimin makroekonomik: shkollat e ndryshme*
- *Konceptet kryesore makroekonomike*
- *Problemet ekonomike: çka, si dhe për kënd të prodhohet?*
- *GDP*
- *GDP dhe mirëqenia ekonomike*

EKONOMIKSI: MIKROEKONOMIA & MAKROEKONOMIA



MENDIMI MAKROEKONOMIK: SHKOLLAT E NDRYSHME

Historiku i mendimit ekonomik: Adam Smithi

KLASIKE: liberalizmi ekonomik, punësimi (punëzënia) e plotë, përdorim i plotë i resurseve, ekuilibri i tregut.

KEJNSIANE - mospërdorimi i plotë i resurseve ekonomike dhe ekuilibri ekonomik, papunësia, raporti papunësi - inflacion (trade-off).

... shkollat (mendimet) tjera ekonomike:

- NEOKLASIKE
- SHKOLLA E PRITJEVE RACIONALE
- NEOKEJNSIANISTET

KONCEPTET KRYESORE MAKROEKONOMIKE

- ➔ GDP (Gross Domestic Product): real dhe nominal
- ➔ Rritja ekonomike (ritmi i rritjes së GDP-së)
- ➔ Inflacioni (ritmi i rritjes së çmimeve)
- ➔ Punësimi dhe papunësia
- ➔ Ciklet e biznesit (inflacioni, rritja ekonomike dhe papunësia) (figura)

OBJEKTIVAT KRYESORE MAKROEKONOMIKE DHE MJETET POLITIKE TË REALIZIMIT TË TYRE

➔ Objektivat e qeverisë

- Punësimi i plotë
- Qëndrueshmëria e çmimeve
- Ritme të përshtatshme të rritjes afatgjate
- Zhvillimi i balancuar rajonal
- Bilanci i ekuilibruar i pagesave

Instrumentet politike

⇒ Politika Fiskale

- Tatimet
- Shpenzimet qeveritare

⇒ Politika Monetare

- Oferta monetare dhe roli i Bankës Qëndrore

⇒ Politika e të Ardhurave

- Politika mbi pagat, dhe
- Politikat mbi çmimet

⇒ Politikat e Marrëdhënieve Ekonomike me Jashtë

- Politikat tregtare
- Politikat valutore
- Koordinimi i politikave të brendshme makroekonomike

PRODUKTI I PËRGJITHSHËM

- ➔ Produkti i përgjithshëm si tregues sintetik i aktivitetit ekonomik
- ➔ Mjet testues për të parë nëse janë arritur objektivat e caktuara (shembull)
- ➔ Përdoret për të bërë krahasime me vendet tjera

PROBLEMET NË LLOGARITJEN E GDP-së

- ⇒ Problemi i agregimit të produkteve dhe shërbimeve të ndryshme
- ⇒ Problemi i rritjes së çmimeve që mund të shpie në konkludimin se është rritur GDP
- ⇒ Pamundësia për të përfshirë përmirësimin e cilësisë dhe rënjen e çmimit (p.sh. rasti i kompjuterëve)

MATJA E PRODUKTIT TË PËRGJITHSHËM

Ekzistojnë mënyra të ndryshme të matjes së Produktit të Përgjithshëm:

- ➔ **Mënyra e Prodhimit**
- ➔ **Mënyra e Shpenzimeve**
- ➔ **Mënyra e të Ardhurave**

...MATJA E PRODUKTIT TË PËRGJITHSHËM

1) MËNYRA E PRODHIMIT:

- Duke mbledhur vlerën e të gjitha produkteve dhe shërbimeve përfundimtare
- Ose duke mbledhur vlerën e shtuar në çdo stad të prodhimit

Stadet apo fazat e prodhimit	Vlera e transaksionit (në € për çdo 100 kg bukë)	Vlera e shtuar (në € për çdo 100 kg bukë)
Fermerët e grurit ia shesin grurin fabrikës së miellit	1000	1000
Fabrikanti i miellit e përpunon grurin në miell dhe ia shet atë prodhuesit të bukës	2100	1100
Prodhuesi i bukës ua shet bukën konsumatorëve	4000	1900
<u>I gjithë procesi i prodhimit</u>	<u>7100</u>	<u>4000</u>

...MATJA E PRODUKTIT TË PËRGJITHSHËM

2) MËNYRA E SHPENZIMEVE:

Duke mbledhur të gjitha shpenzimet e subjekteve të ndryshme për blerjen e mallrave dhe shërbimeve përfundimtare:

$$E = C + I + G + NX$$

E → Shpenzimet Kombëtare
C → Konsumi
I → Investimet
G → Shpenzimet Qeveritare
N → Eksporti Neto

...MATJA E PRODUKTIT TË PËRGJITHSHËM

3) MËNYRA E TË ARDHURAVE

Realizohet duke mbledhur të ardhurat e të gjithë zotëruesve të faktorëve të prodhimit

- Kompenzimet e punënjësve (pagat, etj.)
- Të ardhurat e firmave jo aksionare
- Të ardhurat e individëve nga renta
- Të ardhurat korporative (para taksave)
- Interesi neto

...MATJA E PRODUKTIT TË PËRGJITHSHËM

Disa koncepte:

GDP

GNP = GDP – te ardhurat neto

NDP = GDP – amortizimi i kapitalit

DISA IDENTITETE KRYESORE MAKROEKONOMIKE

Duke supozuar se ekonomia është e mbyllur (pra nuk kemi sektor të jashtëm: import dhe export) dhe duke abstrahuar shpenzimet qeveritare atëherë:

$$Y = C + I \quad (1)$$

Duke supozuar se $Y=YD$, atëherë:

$$Y = C + S \quad (2)$$

Duke kombinuar këto dy ekuacione kemi:

$$C + I = Y = C + S \quad (3)$$

$$I = S \quad (4)$$

Kur shtohet sektori qeveritar dhe sektori i jashtëm:

$$Y = C + I + G + NX \quad (5) \text{ dhe}$$

$$YD = Y + TR - TA \quad (6)$$

Poashtu dimë se:

$$YD = C + S \quad (7)$$

...DISA IDENTITETE KRYESORE MAKROEKONOMIKE

Kombinimi i barazimeve (6) dhe (7):

$$C + S = YD = Y + TR - TA \quad (8)$$

dhe

$$C = YD - S = Y + TR - TA - S \quad (9)$$

Nëse zëvendësojmë C në ekuacionin (5)

$$Y = C + I + G + NX = (Y + TR - TA - S) + I + G + NX$$

Marrim diferencën në dy anët e barazimit të mësipërm:

$$(Y + TR - TA - S) + I + G + NX - Y = 0$$

dhe do të kemi

$$TR - TA - S + I + G + NX = 0$$

dhe

$$I - S + (G + TR - TA) + NX = 0 \quad (10)$$

Shprehja $(G + TR - TA)$ përfaqëson deficitin buxhetor. Nëse $S=I$ atëherë:

$$(G + TR - TA) = -NX \quad (11)$$

Pra deficitin buxhetor është i barabartë me deficitin e tregtisë së jashtme (importin neto).

PRODUKTI KOMBËTAR & MIRËQENIA EKONOMIKE

- ➔ **Mirëqenia ekonomike si objektiv përfundimtar**
- ➔ **Si të matet mirëqenia?**
 - *Si të merret në konsiderim ndotja e ambientit që rezulton nga prodhimi më i madh i produkteve?*
 - *Sipas produktit të përgjithshëm?*
 - *Shpërndarja e produktit (kurba e Gini coefficient)*
 - *Koha e lirë dhe mirëqenia ekonomike*
 - *Problemi i matjes së mirëqenies pasi njerëzit kanë preferenca të ndryshme*

PYETJE PER DISKUTIM

- Pyetjet per diskutim ne kapitullin XIII, faqe 265.
- Te dhenat per GDP dhe agregatet e tjere ekonomik per Kosove per periudhen 2001-2009:
 - >BPK (www.acbk-kos.org)
 - >SOK (www.ks-gov.net/esk)